



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KOMISIONI I POSAÇËM I RINDËRTIMIT

Nr. 1885 prot.

Kamëz, më 25.02.2025

VENDIM

Nr. 1885, Datë 25.02.2025

“PËR
TRAJTIMIN E APLIKIMIT TË Z. ARBEN HAXHIAJ”

Në mbështetje të Ligiit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në zbatim të Aktit Normativ nr. 9, datë 06.12.2019 “Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore” dhe akteve të tjera nënligjore dalë për zbatim të tij, Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit për Objektet Kolektive ngritur me anë të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 492, datë 21.05.2024 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 978, datë 27.12.2022, Mbi ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Rindërtimit për Objektet Kolektive, i ndryshuar, në mbledhjen e datës 28.01.2025 si dhe në vijimësi të diskutimeve të zhvilluara në mbledhjen pasardhëse të datës 18.02.2025, Komisioni mori në shqyrtim dokumentacionin që administrohet në dosjen e krijuar në kuadër të Programit të Rindërtimit për subjektin aplikues Z. Arben Haxhiaj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga drejtoritë përkatëse pranë Bashkisë Kamëz, rezulton se:

- Z. Arben Haxhiaj ka paraqitur kërkesën me nr. 10253 prot., datë 04.12.2024, me lëndë: “Kërkesë për shtëpi”.
- Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit për Objektet Kolektive ka arritur të administrojë të gjithë informacionin e nevojshëm nga Drejtoria e Rindërtimit dhe Legalizimeve nëpërmjet shkresës nr. 10253/1 prot., datë 12.12.2024; shkresës nr. 415/2 prot., datë 14.01.2025; nga Lagjja Administrative nr. 1, nëpërmjet shkresës nr. 59/1 prot., datë 14.01.2025; shkresës nr. 105/1 prot., datë 20.01.2025; si dhe strukturat përgjegjëse të cilët dispononin informacionin përkatës lidhur me trajtimin e rastit të Z. Haxhiaj.
- Me anë të shkresës nr. 676 prot., datë 21.01.2025, me lëndë: “Kërkesë për bashkëpunim”, Drejtoria e Rindërtimit i është drejtuar Komisionit të Posaçëm të Rindërtimit me qëllim shqyrtimin e rasteve të patrajuara nga procesi i rindërtimit.
- Në momentin e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore Bashkia Kamëz me urdhrin nr. 476, datë 01.10.2020 caktoi një strukturë përgjegjëse me qëllim evindentimin e banesave të cilat prekeshin nga termeti i dates 26.11.2019.
- **Grupi i punës ka mbajtur akt konstatimin për evidentimin e ndërtesës së Z. Arben Haxhiaj.**
- Objektet të cilat konsideroheshin të dëmtuara vlerësoheshin nga Instituti i Ndërtimit për një filter të dytë kontrolli (vlerësim më të thelluar). Pas konstatimit nga ana e Institutit të

Ndërtimit, ky i fundit përcillte pranë Bashkisë Kamëz aktin e ekspertizës, ku në të përcaktohej fotoja e banesës, koordinatat e vendodhjes së saj, sipërfaqja e banesës, numri i kateve si dhe rekomandimet e grupit të punës së Institutit të Ndërtimit. Në rastin konkreti Instituti i Ndërtimit nuk ka mbajtur akt-ekspertizë të thelluar.

- Z. Arben Haxhiaj nuk ka aplikuar në sistemin online nëpërmjet shtojcës “A” me qëllim për t’u trajtuar nga programet e procesit të rindërtimit.

Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit bazuar në përcaktimet e aktit normativ me fuqinë e ligjit ka për detyrë të shqyrtojë, vlerësojë dhe kualifikojë subjektet përfitues të banesave të dëmtuara nga tërmeti. Ky komision ka në kompetencë të tij të shqyrtojë vetëm dosjen dhe dokumentacionin e subjekteve, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga tërmeti. Në rastin konkret vlen të theksojmë që ankuesi Z. Arben Haxhiaj, nuk e ka objektin të dëmtuar nga tërmeti.

- Banesa e Z. Arben Haxhiaj nuk është vlerësuar nga autoritetet përgjegjëse si banesë. Ky vendim mbështetet mbi kushtet, kriteret, procedurat dhe rregullat mbi përzgjedhjen e përfituesve nga programi i rindërtimit të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019, bazuar në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

Në kuptim të aktit normativ nr. 9, datë 06.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” [...] *me banesë kuptojmë një ndërtesë ose njësi banimi brenda një ndërtese që përbëhet nga bashkësia e mjediseve ose mjedis i vetëm që ka hyrje të pavarur dhe dalje në kat, oborr, tarracë ose rrugë të destinuar për banim*”.

Instituti i Ndërtimit në cilësinë e autoritetit shtetëror për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin nuk ka lëshuar një Akt-Ekspertizë të thelluar pasi duke iu referuar inspektimit në terren si dhe duke vlerësuar të gjithë faktorët **ky objekt nuk konsiderohet një banesë në kuptim të aktit normativ.**

Në përfundim të vlerësimit të rastit konstatojmë se në kuadër të procesit të rindërtimit për rehabilitimin e komuniteteve dhe rindërtimit të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore mbështetur në Aktin normative nr. 9, datë 16.12.2019 dhe aktet ligjore të dala në zbatim të tij;

Në përputhje të të gjitha fakteve, rrethanave dhe përgjegjësisë të ngarkuara, Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit arsyeton se mbështetur në aktet ligjore të dala në kuadër të procesit të rindërtimit për rehabilitimin e komuniteteve dhe rindërtimit të territoreve të prekura nga fatkeqësitë ka dalë në konkluzionin se:

Z. Arben Haxhiaj nuk ka kryer nje aplikim online ne zbatim te aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave nga fatkeqësië natyrore”, aplikim te cilin e kryenin te gjithë subjektet te cilat jane prekur nga tërmeti I dates 26.11.2019. Objekti i Z. Arben Haxhiaj, nuk është banesë në kuptim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave nga fatkeqësië natyrore”. Ky objekt nuk është prekur nga tërmeti sepse nuk ka nje akt-ekspertize të thelluar nga institute I ndertimit dhe Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit trajton vetëm të prekurit nga tërmeti. Per sa me siper kjo dosje nuk ploteson kushtet ligjore per tu trajtuar nga ky komision


Sa më sipër,

KOMISIONI I POSAÇËM I RINDËRTIMIT PËR OBJEKTET KOLEKTIVE

VENDOSI:

1. Te refuzoj kerkesen e Z.Haxhiaj si subjekt perfitues pasi nuk gjendet përpara fakteve dhe kritereve ligjore për kualifikimin si kategori përfituese.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Komisionin e Apelimit.
3. Kopje e këtij vendimi t'j dërgohet për njoftim subjektit aplikues Z. Arben Haxhiaj.

Eni Bistri



Eronit Lama



Erlend Baballëku



Vjollca Smaçi



Flora Muça

